



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec  
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

RAHOVEC/ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 140 Nr. i faq./Br.str./No.pg 01/23

Dat./Datum/Date 26 / 09 / 2023

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 19, paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.2, të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), konform nenit 22 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2023, merr këtë:

### V E N D I M

1. Me këtë vendim, firmës "**Eurobag Packing L.L.C**" me seli në Mamushë, rr. Kisla Mahallesi, të cilën e përfaqëson Naser Morina nga Mamusha, I JEPET në shfrytëzim afatgjatë deri **25 (njëzet e pesë)** vjet, prona e paluajtshme e komunës, zonën kadastrale Hoçë e Madhe, sipas certifikatës së pronësisë P-71510008-00266-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 10099m<sup>2</sup> (dhjetë mijë e nëntëdhjetë e nëntë metra katror), duke përfshirë zyrat administrative dhe objektin në sipërfaqe prej 2000m<sup>2</sup> (dy mijë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.
2. Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës, fillon të rrjedhë nga data 1.11.2023 dhe përfundon me datën 30.10.2048, ndërsa pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës, e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Rahovecit, si titullar faktik dhe juridik i pronës.
3. Prona e paluajtshme e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, i jepet për ushtrimin e veprimtarisë afariste, sipas rekomandimit të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, me Nr. Prot. 5413, të datës 07.09.2023.
4. Obligohet kryetari i Komunës që, me personin fizik dhe juridik përfitues të pronës së paluajtshme të komunës, të lidhë kontratë me të cilën i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
5. Obligohen shfrytëzuesit e cekur në nenin 1 të këtij vendimi, që pronën e paluajtshme të cekur në nenin 1 të këtij vendimi ta shfrytëzojnë me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.
6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana

e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01-Nr.140/23**  
**Më datë: 26.09.2023**



**Arbër Zenuni**

**Kryesues i Kuvendit**